



Titulli i projektit

Mbledhja dhe përpunimi i mbetjeve urbane

Tipi i projektit

Shërbime Publike

Vendndodhja e projektit

Të gjitha NJQV e ZF Shijak

Buxheti i paravlerësuar

750,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Nga analiza e Zonës Funksionale Shijak, problemi i mbledhjes, përpunimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane del si një ndër problemet kryesore me të cilin ballafaqohen çdo ditë banorët e zonës. Ky shërbim, ose është i pamjaftueshëm, ose nuk ofrohet fare. Kjo ndodh si për shkak të mungesës së një vendi për përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve, ashtu dhe të mungesës së mjeteve përkatëse për të realizuar grumbullimin e tyre nga pikat e caktuara. Megjithëse këto pika ekzistojnë, përsëri ato shkaktojnë probleme, pasi janë shumë afër zonave të banimit. Madje NJQV e kësaj Zone Funksionale, përveç Komunës Maminas, nuk kanë as plane të përgatitura për menaxhimin e mbetjeve, duke ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e treguesve të ambientit, higijenës, sëmundjeve të ndryshme, etj..

Qëllimi/et specifik të projektit

Realizimi i këtij projekti synon të përmirsojë dhe zgjidhë për një afat kohor 20-vjeçar çështjen e mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në një landfill të miratuar. Ky shërbim do të mbulojë të gjithë zonën funksionale Shijak, duke përmirësuar cilësinë e ajrit, ambientit dhe do të parandalojë sëmundjet infektive. Zbatimi i këtij projekti është një premisë e mirë për rehabilitimin dhe rivitalizimin e resurseve natyrore, të cilat fatkeqësisht janë kthyer në zona depozitimi të mbetjeve dhe për rritjen e numrit të vizitorëve/turistëve. Gjithashtu ky projekt përfaqëson edhe një përmirësim të ndjeshëm të shërbimeve publike të ofruara nga bashkia për të gjithë banorët.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

E gjithë popullsia e Zonës Funksionale Shijak përfiton nga ky projekt (27851 banorë). Të gjitha NJQV (4 të tilla) e Zonës Funksionale adresojnë çështjen e mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane. Të gjitha mbetjet e gjeneruara do të depozitohen në vend-depozitimin e ndërtuar. Cilësia e ajrit, ambientit dhe sëmundjeve infektive përmirësohet ndjeshëm e bashkë me to rritet edhe mundësia e vizitorëve/turistëve ditore. Rivitalizohen resurset natyrore të kthyera tashmë në vende depozitimi mbetjesh.

PROJEKTI 6



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

Aktivitetet kryesore të këtij projekti janë si më poshtë:

- Përgatitja e një plani për menaxhimin e mbetjeve të Zonës Funksionale;
- Blerja e 5 mjeteve (kamionë) për mbledhjen e mbetjeve;
- Blerja e 200 koshave për hedhjen e mbeturinave;
- Ndërtimi i një vend-depozitimi për depozitimin e tyre;
- Aktivitete promovuese dhe ndërgjegjësuese.

Maturimi i projektit

Ka vetëm një koncept të qartë për nevojën dhe mundësitë që do të ofronte zbatimin e këtij projekti. Për zbatimin e këtij projekti, hapi i parë që duhet të ndërmerret është marrëveshja me pushtetin vendor.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Duke marrë në konsideratë pamundësitë financiare të pushtetit vendor për financimin e projekteve të kësaj natyre, do të ishte e përshtatshme që të kërkohej financim nga donatorët e huaj dhe fondet e zhvillimit të rajoneve të Qeverisë Shqiptare.

Vetë pushteti vendor do të ishte aktori më i përshtatshëm për zbatimin e këtij projekti, duke marrë parasysh përvojën e grumbulluar ndër vite, njohjen e problematikës dhe riorganizimin e ri të NJQV.

Kostot e projektit

Në bazë të aktiviteteve kryesore të renditura më lart, kostot e përafërta do të ishin si më poshtë:

Përgatitja e një plani për menaxhimin e mbetjeve të ZF	25,000
Blerja e 5 kamionave	250,000
Blerja e 200 kazanave për mbledhjen e mbeturinave	15,000
Ndërtimi i një vend-depozitimi me kapacitet 150,000 ton mbetje të depozituara	450,000
Aktivitete promovuese dhe ndërgjegjësuese	10,000